URDHËR
Nr. 187, datë 7.5.2012

PËR HAPJEN E FAKULTETIT TË INFERMIERISË NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR XHUVANI" TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës të pikave 5 dhe 6 të nenit 41 dhe pikës 1 të nenit 42 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar

URDHËROJ:

1. Hapjen e Fakultetit të Infermierisë në Universitetin "Aleksandër Xhuvani" të Elbasanit.
2. Fakulteti i Infermierisë të ketë në përbërje këto njësi bazë:
a) Departamenti i Infermieristikës;
b) Departamenti i Lëndëve Klinike dhe Paraklinike;
c) Qendra e Kërkimit dhe Zhvillimit Mjedisor e Diagnostikues;
d) Qendra Rajonale Spitalore.
3. Fakulteti i Infermierisë të ofrojë programet ekzistuese të studimit të ciklit të parë që realizohen me 180 kredite, me kohëzgjatje normale jo më pak se 3 vite akademike, në përfundim të të cilave lëshohet diplomë universitare "Bachelor" në:
a) Infermieri e përgjithshme;
b) Infermieri-mami.
4. Fakulteti i Infermierisë të ofrojë programin ekzistues të studimit të ciklit të dytë, që realizohet me 90 kredite me kohëzgjatje normale 1.5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master profesional", në "Menaxhim Infermieror".
5. Efektet financiare për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i universitetit "Aleksandër Xhuvani" të Elbasanit, pa efekte buxhetore shtesë.
6. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe universiteti "Aleksandër Xhuvani" i Elbasanit, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj